



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government
Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistiku Kosova – Kosovo Agency of Statistics

Indeksi i Kostos të ndërtimit Tm1-2016

Indeksi i kostos të ndërtimit (IKN) / tremujori I, 2016

Indeksi i tërësishëm i kostos të ndërtimit (IKN) në tremujorin e parë (Tm1) 2016 në Kosovë ka rritje prej 1.0 % krahasuar me tremujorin e katër (Tm4) të vitit 2015 . Krahasuar me tremujorin e njejt te vitit 2015 IKN pati nje renie prej -0.1%.

Rritja e Indeksit te ndertimit verehet te makineria me nje rritje prej 2.7 % dhe te materialet ndërtimore me 1.6 %.

Rënia e indeksit të çmimeve të kostos të ndërtimit është vërejtur te materialet elektrike prej -2.1% .

Tremujori i parë 2016 / Tremujori i parë 2015

Krahasuar me periudhën e njëjte të vitit paraprak (Tm1 2016/Tm1 2015), IKN-it ka rënie për -0.1 %.

Rënia e Indeksit të çmimeve të kostos të ndërtimit është vërejtur te disa kategori si: transporti me -20.0 % ,dhe të materialet elektrike prej -3.0%

Rënia e çmimeve më të njëjtën periudhë të vitit paraprak u neutralizua me ngritjen e çmimeve të : pagat prej 4.2% , makinerit 3.1 % si dhe të energjia me 1.6 % .

Shpjegim shtesë:

Kalkulimi i Indeksit të kategorisë se **Energjisë** bëhet nga të dhënat e Indeksit të Çmimeve të Prodhimit i cili është në përputhshmëri me klasifikimin standard të veprimtarive NACE rev .2, dhe i cili është i bazuar në “ Rregulloren nr. 11/2013 neni 7” .

Te kategoria **kostotot e tjera**, kalkulimi i indekseve bëhet nga ecuria e indekseve te harmonizuara te çmimeve konsumit.

Tabela 1: Indeksi i kostos të ndërtimit për ndërtesat shumëkatëshe (viti bazë 2015=100)

		Kategorite e Kostove									
		Materialet (a+b+c)	(a).Materialet ndërtimore	(b).Materialet elektrike	(c).Materialet hidro-sanitare	Pagat	Makineritë	Transporti	Energjia	Kostot e tjera	Gjithsej
Peshat		69.8	60.4	5.1	4.3	16.4	5.9	3.8	1.4	2.7	100.0
2013	Periudhat Tm1	100.4	100.7	96.4	99.8	96.8	95.5	105.3	86.2	100.8	99.5
	Tm2	100.6	101.0	96.7	99.5	96.8	95.5	105.3	81.8	99.8	99.6
	Tm3	100.8	101.3	95.8	99.5	96.8	95.5	105.3	81.8	99.5	99.7
	Tm4	100.5	101.0	95.7	99.4	96.8	95.5	105.3	88.9	100.3	99.6
2014	Periudhat Tm1	100.7	101.4	95.7	97.8	96.8	96.1	105.3	89.0	101.0	99.8
	Tm2	100.8	101.3	97.4	97.8	96.8	98.4	105.3	86.4	100.2	99.9
	Tm3	100.7	101.2	97.7	97.8	96.8	98.4	105.3	87.2	100.5	99.9
	Tm4	100.3	100.6	98.7	97.8	97.0	99.8	105.3	99.4	100.4	99.9
2015	Periudhat Tm1	100.5	100.6	100.4	99.5	97.0	99.8	105.3	99.4	100.6	100.1
	Tm2	100.1	100.2	99.2	99.5	101.0	99.8	105.3	100	99.8	100.4
	Tm3	100.2	100.2	100.9	100.5	101.0	100.1	105.3	100.1	99.6	100.5
	Tm4	99.2	99.0	99.5	100.5	101.0	100.2	84.2	100.4	100.0	99.0
2016	Periudhat Tm1	100.4	100.6	97.4	100.5	101.0	102.9	84.2	101.0	100.6	100
	Tm2										
	Tm3										
	Tm4										

Figura 1: Zhvillimi i IKN,Tm1 2013 – Tm1 2016 (2015=100)




Tabela 2: Indeksi i kostos të ndërtimit për ndërtesat shumëkatëshe (2015=100) - ndryshimet tremujore dhe vjetore në përqindje

Indeksi (2015=100)		Ndyshimet tremujore ne %	Ndyshimet vjetore në perqindje %
2013 Periudhat	Tm1	99.5	:
	Tm2	99.6	0.1
	Tm3	99.7	0.1
	Tm4	99.6	-0.1
Mesatarja vjetore 2013		99.6	:
2014 Periudhat	Tm1	99.8	0.1
	Tm2	99.9	0.0
	Tm3	99.9	0.0
	Tm4	99.9	0.0
Mesatarja vjetore 2014		99.9	:
2015 Periudhat	Tm1	100.1	0.3
	Tm2	100.4	0.1
	Tm3	100.5	-1.5
	Tm4	99.0	1.0
Mesatarja vjetore 2015		100.0	:
2016 Periudhat	Tm1	100.0	1.0
	Tm2		
	Tm3		
	Tm4		
Mesatarja vjetore 2016			

Tabela 3: Peshat, ndryshimet mujore dhe vjetore në përqindje sipas kategorive të Kostove

Kodi	Kategoritë të kostove	Peshat	Tm1-2016 2015=100	<u>Tm 1 - 2016</u> Tm 4 - 2015	<u>Tm 1 - 2016</u> Tm 1 - 2015
1	Materialet (a+b+c)	69.8	100.4	1.2	-0.1
	a. Materialet ndërtimore	60.4	100.6	1.6	0.0
	b. Materialet elektrike	5.1	97.4	-2.1	-3.0
	c. Materialet hidro-sanitare	4.3	100.5	0.0	1.0
2	Pagat	16.4	101.0	0.0	4.1
3	Makineritë	5.9	102.9	2.7	3.1
4	Transporti	3.8	84.2	0.0	-20.0
5	Energjia	1.4	101.0	0.6	1.6
6	Kostot e tjera	2.7	88.1	0.6	0.0
Gjithsej		100.0	98.3	1.0	-0.1

Përshkrimi metodologjik i Indeksit të Kostos së Ndërtimit për ndërtesat shumëkatëshe të banimit

Indeksi i Kostos së Ndërtimit mat zhvillimin e çmimeve të faktorëve të prodhimit të lëndëve të para, të pagave, makinerive, transportit, energjisë dhe kostot e tjera që përdoren në projektet e ndërtimit. Indeksi mat ndryshimin e çmimeve për faktorët individualë të prodhimit dhe i peshon këto në përputhje me një sistem të caktuar të peshimit. Indeksi nuk mat ndryshimet e produktivitetit të tilla si përdorimi më i mirë i materialeve, apo faktorët e tjerë, e as nuk pasqyron marzhat e fitimit.

Popullsia

Indeksi i Kostos së Ndërtimit është i kufizuar për ndërtesat e saponëduara shumëkatëshe, që është lloji më i zakonshëm i projektit të ndërtimit në Kosovë. Indeksi llogaritet për të gjithë Kosovën.

Kategoritë e Kostos

Indeksi i Kostos së Ndërtimit për banesat shumëkatëshe përfshin gjashtë kategori të kostos si në vijim:

- Materialet
- Pagat
- Makineritë
- Transporti
- Energjia
- Kostot e tjera

Indeksi model

Nga tremujori i parë i vitit 2016, modeli i indeksit për Indeksin e Kostos së Ndërtimit ka ndryshuar nga indeksi bazë fiks në llojin e indeksit zinxhir me lidhje vjetore të Laspeyerit. Arsyeja kryesore për ndryshimin e modelit të indeksit nga indeksi me bazë fikse në indeks të zinxhirit është se kjo mundëson përfshirjen e artikujve të ri ose të fshijë artikujt e vjetër të cilët nuk janë më të rëndësishëm. Arsyeja e dytë është harmonizimi i IKN-së me treguesit e tjerë të çmimeve të prodhuara nga ASK-ja të cilat përdorin modelin e indeksit zinxhir.

Periodha referuese e indeksit referencë (periodha bazë) në të njëjtën kohë është ndryshuar nga tremujori i parë i vitit 2013 me mesataren e vitit 2015 (viti bazë 2015 = 100).

Indeksi i Laspeyerit është përcaktuar si

$$I^t = \frac{\sum_{i=1}^n P_i^t Q_i^0}{\sum_{i=1}^n P_i^0 Q_i^0} = \sum_{i=1}^n \frac{P_i^0 Q_i^0}{\sum_{i=1}^n P_i^0 Q_i^0} \times \frac{P_i^t}{P_i^0}$$

Ku P^0 dhe P^t janë çmimi për njësi në periudhën bazë (0) dhe periudha e krahasimit (t), respektivisht, dhe Q^0 është sasia e periudhës bazë. Mbledhja bëhet nëpërmes produkteve n. Në elementin e parë të mësipërm, indeksi shprehet si raporti midis vlerës së mbledhur të sasive të periudhës bazë në periudhën e krahasimit dhe, respektivisht, nivelit të çmimeve të periudhës bazë. Indeksi gjithashtu mund të shprehet, si në elementin e dytë, si mesatare e përafërt e çmimeve të prodhimeve të peshuar me vlerat e periudhës bazë.

Lidhjet e indeksit llogariten me tremujorin aktual q në vit y si periudhë e krahasimit dhe me tremujorin e katërt në vitin $y-1$ si periudhë referuese e çmimeve. Periudha e peshimit është tremujori i parë i vitit 2013. Andaj, lidhja përkufizohet si:

$$I_{y-1,q4}^{y,q} = \sum_{s=1}^k \frac{V_s}{\sum_{s=1}^k V_s} \times \frac{I_s^{y,q}}{I_s^{y-1,q4}}$$

Ku pesha e vlerës V_s është vlera e transaksioneve në Tm1 2013 që përfaqësohen nga kostoja e artikullit s . Mbledhja bëhet nëpërmes artikujve të kostos k . Indeksi i periudhës së referencës së çmimit për periudhën e krahasimit llogaritet në dy hapa:

$$\frac{I_s^{y,q}}{I_s^{y-1,q4}} = \frac{I_s^{y,q}}{I_s^{y,q-1}} \times \frac{I_s^{y,q-1}}{I_s^{y-1,q4}}$$

Llogaritja e indeksit zinxhiror

Numri i indeksit zinxhiror llogaritet për tremujorët dhe tregon nivelin e veçantë të çmimit të tremujorit në krahasim me nivelin e çmimit mesatar në vitin 2015 (2015 = 100).

$$I_{2015}^{y,q} = \frac{100}{\frac{1}{4} \sum_{q=1}^4 I_{2014,q}^{2015q}} \times \prod_{Y=2015}^{y-1} I_{Y-1,q}^{Y,q4} \times I_{y-1,q}^{y,q}$$

Llogaritja e ndryshimeve

Ndryshimi tremujor llogaritet si:

$$\left[\left(\frac{CCI_{2015}^{Y,q}}{CCI_{2015}^{Y,q-1}} \right) - 1 \right] * 100 = \text{Ndryshimi i përqindjes në tremujor}$$

Ndryshimi vjetor llogaritet si:

$$\left[\left(\frac{CCI_{2015}^{Y,q}}{CCI_{2015}^{Y-1,q}} \right) - 1 \right] * 100 = \text{Ndryshimi i përqindjes në vjetor}$$

$CCI_{2015}^{Y,q}$ = Indeksi zinxhiror i kostos së ndërtimit për tremujorin aktual q

$CCI_{2015}^{Y,q-1}$ = Indeksi zinxhiror i kostos së ndërtimit për tremujorin paraprak q-1

$CCI_{2015}^{Y-1,q}$ = Indeksi zinxhiror i kostos së ndërtimit për vitin paraprak y-1 dhe tremujorin q

Mbledhja e të dhënave

Për materialet e ndërtimit, çmimet mblidhen nga furnizuesit e materialeve të ndërtimit. Furnizuesit kanë të bëjnë drejtpërdrejt me kontraktorin. Për të mbledhur informacionin e çmimeve, një pyetsorë u dërgohet kompanive ku ASK-ja në mënyrë specifike tregon se për çfarë produkti po mblidhen informatat për çmimet. Furnizuesit e dhënave mund të shohin se çfarë çmimi i kanë dorëzuar ASK-së në tremujorin e fundit. ASK kërkon çmimet mesatare që kompanitë i kanë për produktet e tyre çdo tre muaj.

Kostot e pagave mblidhen nga kompanitë ndërtimore.

Për kostot e makinerive, ASK-ja mbledhë çmimet për makinat e vogla që përdoren në sektorin e ndërtimtarisë.

ASK-ja mbledhë çmimet për shërbimet e transportit të materialeve ndërtimore nga disa kompani logjistike.

Kostot e energjisë mblidhen nga Indeksi i Çmimeve të Prodhimit në kuadër të ASK-së.

Të dhënat për kostot e tjera mblidhen nga Indeksi i Çmimeve të Konsumit në kuadër të ASK-së.

Peshat

Peshat për Indeksin e Kostos së Ndërtimit bazohen në pyetësorin për kompanitë e ndërtimit. Siç u përmend më lart, peshat janë nga tremujori i parë i vitit 2013.

Përdorimi i Indeksit të Kostos së Ndërtimit

Indeksi i Kostos së Ndërtimit për ndërtesat shumëkatëshe është indikator i rëndësishëm për palët e interesit, si dhe për analizimin e sektorit të ndërtimitarisë. Mund të përdoret edhe si deflator tek llogaritë kombëtare për ndërtimin e ndërtesave të reja shumëkatëshe.

Publikimi i rezultateve

Rezultatet e Indeksit të Kostos së Ndërtimit publikohen në faqen e internetit të ASK-së çdo tre muaj.

Publikimi është përgatitur nga:

Ilir T.Berisha – Drejtor i Departamentit Ekonomik dhe Llogaritë Kombetare

Ibish Asllani – Shef i Divizionit

Arlinda Mataj – Zyrtare e lartë

Qershor, 2016

Kryeshef Ekzekutiv,ASK
Isa Krasniqi

Informata për kontakt në Agjencinë e Statistikave të Kosovës

- **Adresa:** AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS,
Rr. "Zenel Salihu", nr. 4, 10000 Prishtinë
- **Telefoni:** +381 (0) 38 200 31 129
Kryeshefi Ekzekutiv: +381 (0) 38 200 31 112
- **Fax:** +381 (0) 38 235 033
- **E-mail:** infoask@rks-gov.net
- **Ueb-faqe:** <http://ask.rks-gov.net>